

THE CHARACTER OF KADARE IN RELATION TO TIME AND SPACE

Arlind FARIZI

University of Tetova, Faculty of Philology, Albanian Language and Literature

arlind.farizi@unite.edu.mk

UDC 821.18.09

Professional paper

Abstract

To read deep inside and to study a writer, that it was so kind with the time, so friendly with it, it was an exciting experience for the reader. To read the writer who was in disagreeing of the socialist realism to read deep down the Kadare, even as the monist political system has fallen, will say to have again the knowledge of that time, even to feel it that in all the its contest, this taste is unchanged, fresh and the uncial, that seems after each reading and rereading. Its actors are compatriot, so as the modern that must create an open last literature.

Key words: *Character, Kadare, time, space, Albanian literature.*

Përbledhje

Të lexosh përthellë dhe të studiosh një shkrimtar, që ishte kaq i dashur me kohën, kaq miqësor me të, ishte për lexuesin një përjetim i jashtëzakonshëm. Të lexosh përthellë Kadarenë, edhe pasi ka rënë sistemi politik monist, do të thotë të keshë përsëri një shije të kohës, madje ta ndjesh atë në të gjithë përmasën e vetë. Kjo shije është e pazëvendësueshme, e freskët dhe unike, që ngjet pas çdo leximi i rileximi.

Fjalët kyçë: *Personazhi, Kadare, koha, hapësira, letërsia shqipe.*

Hyrje

Në hyrje të këtij sythi të vogël studimor duhet theksuar, me shqyrtim të argumentuara, se vlera më e madhe e letërsisë shqipe në fakt po kaq e personazhit kadarean, është te teknika shkrimore dhe mjeshtëria në formatimin e tyre në kohë dhe hapësirë, në stilin unikal se si ai ngjyrosi përmes tyre një kohëhapësirë të errët e diktoriale, të ndryshëm nga ai që ne kemi jetuar me një shije bashkëkohësie.

Gjykoj se vlera e personazhit të tij, pra e shumicës së personazheve në tekstet romanore, qëndron kryesisth në *shpluhurosjen e antikes, përzierjes me miti, me rikthimin e mitit, me kronotopin e veçantë*. Duke shpluhurosur mitet, dramat, tragjeditë antike, në disa nga romanet e tij më të realizuar, Kadare përmes personazhit të tij mjeshtërisht ia mbërriti që të eliminonte distancën kohore dhe hapësinore dhe e sjell të freskët të lexuesi. Shto kësaj rrethanat e përvëçme në të cilat jetoi personazhi edhe një element tjeter thelbësor të romaneve të tij, KOHËN (dhe pse atij vetë i pëlqen të përdorë shprehjen “i pakohë”.)

Duke i njojur, përmes romanesh, leximesh dhe debatesh, por në mënyrë të veçantë në atë botë që na e sugjeron autori me personazhet e tij të shumta, gjykoj bazuar në faktet reale studimore dhe po kaq edhe në faktet letrare, se komunizmi ishte regjim që e shtypte kohën. Ai madje, jo vetëm në kuptimin metaforik, e ndaloi kohën, prandaj personazhi kadarean paraqet një komponentë thelbësore të poetikës së romaneve të Ismail Kadaresë. Personazhi në raport me kohën del kudo...

Raporti i personazhit me kohën dhe hapësirën

Personazhi në raport me kohën, konceptohej vetëm si e shkuar dhe e ardhme, pra pa të tanishme, që ishte humbje e një përmase jo të vogël. Në socializëm, si një element parimi, i ekzistencës dhe funksionimit të vetë sistemit, s'ka të tashme: çasti, sado me vlerë që të jetë, sakrifikohet gjithnjë në lavdet që i thuren përpjekjeve në të shkuarën dhe perspektivës plot lavdi të së ardhmes, duke krijuar një èndërr fiktive, që duke i munguar e tanishmja, edhe dy kohët e tjera, pra e shkaruara dhe e ardhmja, mbetën pezull.

Dhe Kadare, përmes personazhit të tij, që kanë vënë në qendër pakohësinë, mbetet *këngëtori* më i madh i kësaj *jo-të-tashmeje*. Në romanin *Darka e gabuar* përmes personazhit të tragjikomizmitregohet zhdukja e qytetërimit Perëndimor, krijimi i një kohe të re, i një njeriu të ri, i një pështjellimi shoqëror të pashoq që do të vijonte me krime të rënda të shqiptarëve kundra shqiptarëve në emër të një ideologjie të sertë. Në një radhë titujsh simbolikë si “tjetër rend”, “dita dy ag”, “dita minus dy”, “varg ditësh e muajsh”, “varg stinësh” etj autori pëershruan restaurimin e sistemit komunist.

Kadare, në kuptimin metaforik, vjen nga një qytet “i gurtë”. Gjirokastra e Kadaresë, në disa romane shfaqet përmes personazhit të saj, qytetarit të saj dhe kjo në shumë dimensione e tregon raportin e autorit me hapësirën... Qyteti është hapësirë dhe koncept vetedije. Ky raport është i theksuar edhe te romani “Kronikë në gur”. Kadare nuk pikuron topografinë fizike të qytetit, por një topografi shpirtërore: historinë mesjetare të qytetit, fqinjësitë e tij, marrëdhëni me Perandorinë Osmane, pushtimin gjerman, pushtimin italian, pushtimet..., vendosjen e komunizmit, krimet dhe dashuritë, intrigat dhe kurthet, çmendurinë dhe xhelozinë, meskinitetin që prodrojnë vendbanimet e vogla etj.

Për dallim nga *koha, hapësira* ofron mundësi të merresh me të, të endesh në të, të kotesh në të, të lëvizësh në një zonë të pamodifikueshme, koha është e pandalshme, koha shkëputet, ndërpritet, rimerret, fragmentarizohet, si kohë afektive e lidhur me kohën historike. Në këtë periudhë, jo vetëm shqiptarët e Shqipërisë diktoriale persekutoheshin nga censura dhe mungesa e lirisë, por nga kjo rrethanë që e pati rrënuar jetën dhe liritë njerëzore. Atëherë, kur bota përqark, përgjithësisht nuk vërente tmerret e izolimit shpirtëror, psikologjik e territorial në trojet shqiptare, Kadare vjen në letërsi me një karakter tërësisht unikal të shprehjes e mendimit kijues, të një tipologjie romanesh që na zbulojnë ftyra të shumta personazhesh.

Në këtë kohë romani si zhanri më i parapëlqyer, po përpinqej që t'i mbijetonte këtij realiteti të dhimbshëm dhe ngase censura zyrtare përndiqte çdo shkarje mendimi, çdo rrekje për të vënë në dyshim modelin e sistemit letrar të realizmit socialist, ndërkokë që gjuha poetike e Kadaresë, merr dhe shqiptaon performancat më të përkryera simbolike e metaforike, nën të cilën fshihej revolta, dhimbja dhe thirrja për ndryshim, edhe një prani e disidencës estetike.

Në disa raste, për tekste të caktaura romanesh, është mbikqyrja ajo që bën Kadaresë të përpunojë stilin, të krijojë vizionin dhe poliseminë semantike, çka ka bërtë që të krijohet një situatë e tjetersojshme në marrëdhënie me kohën dhe hapësirën, me modelin letrar, aq dyshues në lidhje me tipet e shkrimit. Në romanet e Kadaresë, që u shkruan në një periudhë prej disa dekadash, shoqëruar me një izokronizëm të dukshëm, vërehet një strukturë tipike lineare, e cila evoluon gradualisht drejt një stili dhe strukture të veçantë poetike.

Kadare vjen në letërsinë shqiptare me të drejtën e madhe për të transformuar: kuptimet, figurat, situatat dhe po kaq edhe gjendjet afektive. Kadare, në shkrimin romanesh e sidomos në gdhendjen e personazheve, arrin të ndryshojë në diskurse trajtat të mendimit, të shpallura në përputhje me momentet historike, psikologjike e metafizike të personazhit, si një bashkëbisedim unik.

Në veprën e Kadares, në të vërtetë, **koha** nuk është element esencial, por referimi i vvetvetes së personazhit në kohën e shkuar dhe të tashmen, lë jo pak hapësirë për të kuptuar se

vizioni i tij mbi të keqen është shtjelluar, duke u bazuar në fenomenet e reflektimit në vështrimin e tij si qenie njerëzore dhe qenie krijuese. Kështu: Kadare në shumicën e romaneve të tij e gjen të keqen në të gjitha fazat e jetës dhe në hapësira të ndryshme kohore dhe madje ndërton me mjaft koherencë apologjinë e imazheve vizionare, në periudha të ndryshme të ekzistimit.

Pra: ky vizion është një gjetje e thellë, e menduar mirë dhe e kuptimësuar në fjalë, pas krijimit dhe konsolidimit të imagjinatës për të kriuar një vizion të tillë, tërësisht të ndyshëm nga autorë të tjerë, sepse në asnje fjalë kadareane të përsëritur nuk ndodh të gjesh të njëtin refleks apo mendim.

Personazhi në raport me kohën

Do vërejmë më poshtë se si ndryshon tërësisht vizioni semantik dhe ndërtekstual, duke i'u referuar përsëri konceptit **kohë** dhe **njeri**, si marrëdhënie që sjellon kohën. Simbolet e pranishme metaforizohen dhe ndërtekstet ndërrojnë diskurs narrativ shpesh herë, si një model i kërkimit letrar në lavrimin e romanit, që zbulojnë figura të shumta njerëzore.

Koha dhe *Hapësira* në romanet e Kadaresë, përgjithësisht nga studimet letrare trajtohen si dy etnitete të veçanta dhe si madhësi absolute. *Koha* na paraqitet si *palimsest* dhe si *alergji iluzore* e të jetuarit, ndërsa *hapësira* analizohet, ndahet, shndrit, gjithnjë brenda kohës “së brendshme”... KOHA si *kategori filozofike*, është një ndër konceptet më të mistershme të metafizikës. Nga këndvështrimi filozofik KOHËN do të mund të përshkruanim kështu: *Koha është gjendje e mendjes; Koha është përhershshmëri e së tashmes; Koha është ireversibile, infinitive; Koha është esenca e jetës.*¹

Koha dhe hapërsira në romanet e Kadaresë, natyrisht në romanet historike nuk paraqitet si inferiore, pra e pamatshme. Ajo është e pranishme si në kuptimin e drejtpërdrejtë, ashtu edhe në atë artistik, duke përplotësuar kështu përmasën e vetë reale. Ajo duket sikur nuk merr fund as pas vdekjes fizike të autorit, teorikisht dhe praktikisht jeton q sa jeton vepra e tij letrare, e vepra e tij nuk vdes, sepse ka lexuesin e pavdekshëm... Koha, si dimension dinamik, është e pranishme edhe aty ku optika meditative dhe letrare mëkon të shprehë sisteme të vjetra mbi të cilat ngrihet parrënueshëm e reja.

Përjetimi i kohës si koncept *ontologjik* meriton një studim në frysë e *historicizmit transcendental-hegelian*² dhe padyshim edhe atë *antiutopik*. Pikërisht ky koncept i një

¹ Osman Gashi, *Kufijtë e letërsisë*, Prograf, Prishtinë, 2008, fq. 19.

² Këtu (si gjithkund dhe për gjithçka tjeter) mendoj se është e nevojshme t'i referohemi HEGELIT dhe tezës që ai e shtron në Estetikën e tij. Për çdo etapë të zhvillimit historik të artit, Hegeli e shtron këtë pyetje: *çfarë duhet të*

marrëdhënie të ndërvarshëmrisë së kohës, rikthehet në letërsinë shqipe, veçanërisht me romanet e Kadaresë, sidomos me romanet historike që vijnë në kohën e duhur si një sihariq ogurmirë për letërsinë.

Koha në romanet tij shfaqet si: *palimpsest* dhe *si alergji iluzore e të jetuarit*. Janë fragmente kaq të gjëra romanore, të cilat jasin artistikisht qartë konceptin e kohës *si palimpsest* dhe *si iluzion*, por nuk përashtohet dhe koncepti i *përsëritjes ciklike të kohës*.

Personazhi në raport me hapësirën

Mjafton të nënvojimë faktin se në romanin Kush e solli Doruntinën ku ai jep tërë katharzën e tij për “*transformimin e kohës në hapësirë*”:³ Pikërisht, ky roman në tëresinë e vetë, por edhe në morinë e elementeve thadruar të artit, edhe vërteton atë që thotë studiuesi kroat *Ante Stamac* se “*kohën*”, “*nuk mund sjellim në raporte kuantifikuese, diskontinuele, në thelb raporte hapësinore dhe shkak – pasojë që mund të interpretohen si pozitiviste nga se vepra është refleksioni i saj më i thelle*”.⁴

Shpirti i besës vjen më tepër si një dorë magjike mbi kokën e shkrimitarit sa për ta rehatuar dhe qetësuar, në vorbullën e një bote mitike të pazakontë, si për ta mbrojtur për një çast atë nga pagjumësia, nga nata neurotike, nga identiteti në rrezik, të cilat mblooden në një moment të caktuar për të vënë në sprove dije dhe vetëdijen krijuese, që rrëmih në një botë të jashtëzakonshme.

Koha e Kadaresë, në kuptimin real dhe formula, ishte koha e përbajtjeve kic, letërsisë me logjikë “*filistine*”, e poezive me aromë konjaku, e shkrimeve nga burreca e gra azgane, kohë poeteshash punëtore, kohë meskinitetesh letrare e talentesh të pazbuluar, ishte kohë hatri e pudre, me një fjalë ishte një kohë pa kohë, kur letërsia kishte rrëshqitur në shërbim të sistemit dhe të ideologjisë së pushtetit, duke braktisur në shumicën e vetë shenjat letrar.

Problemi qendror *ontologjik* i romaneve të Kadaresë që krijohet në Shqipëri është përfjetimi i KOHËS si përmasë imaginare, me një *vetëdije transcedenatale*. *Mihail Bahtin* është ndër të parët studiues të letërsisë që nga konceptet e kohës dhe hapësirës, nxorri përfundime të pazakonta. Ai krijoi një term gjithëpërfshirës “*kronotopos-in*” dhe njëkohësisht e linte të hapur

jetë gjendja e përgjithshme e botës për ta bërë të mundshme këtë apo atë formë të artit? Për Hegelin, çdo “*filozofi e madhe dhe e vërtetë është përgjigje ndaj nevojave të një epoke*”.

³ Osman Gashi, *Kufijtë e letërsisë*, Prograf, Prishtinë, 2008, fq. 24.

⁴ Ante Stamac, *Ranjevi opis sustava (Përshkrimi i dhembshëm i sistemit)*, Zagreb, 1996.

mundësinë e vështrimit të tij nga perspektiva të ndryshme: *mitike, poetike, historiografike, komparative, retorike, gjenealogjike, kulturologjike*.

Te romanet e Kadaresë kemi vështrimin: *mitik, poetik, gjenealogjik, kulturologjik, komparativistik*. Kadare gjykon lehtësisht për KOHËN sepse është dëshmitar i saj, madje me veprën e tij të gjerë letrare, është edhe kronikan i saj. Ai synonte diçka *metakohore* për të ndryshuar rrjedhën e përditshmërisë bajate që kishte ngulfatur jetën e njeriut, si individ dhe komunitet. Mjafton në këtë rast vetëm rileximi i romanit Kush e solli Doruntinën që të kuptohet se si është praqitur dhe si interpreton vetvetishëm këtë kërkesë subjektive. Kemi që në fillim rrëfimtarin që komunikon drejtpërdrejt me lexuesin duke e lidhur atë pas vetes.⁵

Proksemika apo studimi i kohës dhe hapësirës gjatë komunikimit me romanet e Kadaresë, si një moment thelbësor për të hyrë në marrëdhënien dhe për të kuyptuar së çfarë ka ngjarë realisht me letërsinë shqipe, në fakt ngushton ndjeshmë çdo distancë interpretimi. Ajo rrezikon që të prishet deri në shkërmoqje të plotë nëse largohet distanca mes poezisë dhe interpretimit të saj. Qasjet me të cilat i hyjmë romaneve të tij në kohë dhe hapësirë janë *subjektive* dhe të *dyfishta*.

1. Janë *subjektive* për shkak sepse kohën dhe hapësirën e pranojmë si një gjë të rëndomtë dhe nuk arrijmë dot të atribuojmë indiferencën ndaj diktatit të hapësirës ndaj rrjedhës së kohës, pra më tepër e sendërtuar si një marrëdhënie e mirëfilltë personale.
2. Janë të *dyfishta* nga shkaku se të dyja kanë ligjet e veta të thella dhe përcaktuese për vlerën romanore.

Ajnshtajni pohonte se *koha* nuk ekziston në absolut; ajo ndryshon sipas lëvizjeve të një vrojtuesi. *Në letërsi noción pér kohën është drejtvizor*. Të jesh “*prapa kohës*”, si një përcaktim metaforik, do të thotë të tërhiqesh në një kohë të shkuar, të largët apo të afërtë, në një hapësirë malli që për gjasë mund të quhej *anatopi*. *Anatopia* në romanet e Kadaresë, përgjithësisht është inekzistente.

Në pol të kundërt gjendet *metatopia* një përvojë *hapësinore-kohore* me të cilën lidhet letërsia moderne dhe me cilësitë tipike të romaneve kadareane. Nga kjo del natyrshëm se ISMAIL KADARE ËSHTË SHKRIMTAR MODERN PËR NGA KRONOTPIA. Ai pozicionohet “*përsipër kohës*” pra mbi kohën e tij, që nënkupton të jesh i çliruar nga tmerri i të nënshtuarit të kohës...

Përfundimi

⁵ Floresha Dado, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri Tiranë, 2006, fq. 104.

Kadare e flak “të kaluarën absolute” (M. Bahtin) dhe universumi epik, të pakapshme për përvojën personale dhe për vlerësimin e protagonistëve. Me një fjalë, falë llojulloshmërisë së objektit të tij dhe elanit të imaginatës së tij zhvilluese, romani u çlirua nga kodeksi i poetikës së klasicizmit duke gjetur forcën e vet në shprehjen e një përvoje polimorfe. Në vizionin epik, koha është vlerë për vete.

Romani, që nga fillimi, krijon një ide tjetër për kohën”.⁶ Në fund, themi konstatimin e pagueshëm të studiuesit Shaban Sinani se Kadare si ishte një dritare mes dy botësh...⁷

Bibliografia

- Grup autorësh (1980). *Çështje të romanit*, Prishtinë: Rilindja.
- ÇABEJ, Eqrem (1937). *Për gjenezën e literaturës shqipe*, Tiranë.
- ÇAPALIKU, Stefan (2006). *Estetika moderne*, Tiranë: SHBLU.
- ÇAUSHI, Tefik (2000). *Klubi i personazheve*, Tiranë: Dajti.
- GASHI, Osman (2008). *Kufijtë e letërsisë*, Prishtinë: Prograf.
- DADO, Floresha (2006). *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Tiranë: Onufri.
- KOVAÇ, Nikolla (2004). *Romani politik evropian*, Shkup: Gjurgja.
- SINANI, Shaban (2005). *Një dosje për Kadarenë (II)*, Tiranë: Albas.
- STAMAC, Ante (1996). *Ranjevi opis sustava (Përshkrimi i dhembshëm i sistemit)*, Zagreb.
- VINCA, Agim (2012). *Metoda letrare*, Prishtinë: Libri Shkollor.

⁶ Nikolla Kovaç, *Romani politik evropian*, Gjurgja, Shkup, 2004, fq. 47.

⁷ Shaban Sinani, *Një dosje për Kadarenë (II)*, Albas, Tetovë, 2005, fq. 29.